

VENDIM
Nr.661, datë 28.9.2011

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË TË NDJERIT, RRESHTER AGIM
MEKOLLARI, ISH-EFEKTIV I QENDRËS SË ASGJËSIMIT TË MUNICIONEVE DHE
EKSPLOZIVËVE, NË BRIGADËN LOGJISTIKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, I CILI
KA HUMBUR JETËN NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 28 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare, prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, familjes së të ndjerit, rreshter Agim Mekollari, ish-efektiv i Qendrës së Asgjësimit të Municioneve dhe Eksplozivëve, në Brigadën Logjistike të Forcave të Armatosura, i cili ka humbur jetën në krye të detyrës, në poligonin e asgjësimit të municioneve në Bigaz, Skrapar.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
 3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha